



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 1786 Prot

Shkodër, më 14 . 05 .2025

URDHËR

Nr. 63 , datë 14 . 05 .2025

**"PËR HAPJEN E APLIKIMEVE PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË KRIJUAR PËR
SEKRETAR NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE NË USH"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 36, pika 6 dhe neni 39; Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës, neni 6, pika 1, gërmat a) dhe c); si dhe duke qënë se në dy thirrjet e publikuara nuk u paraqiten kandidatura për pozicionin e sekretarit të KIZ,

URDHËROJ:

1. Hapjen e aplikimit për plotësimin e vakancës së krijuar për sekretar i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).
2. Të drejtën për t'u vetëkandiduar për sekretar i KIZ e ka personeli akademik me kohë të plotë në USH.
3. Data e dorëzimit të aplikimeve do jetë **15. 05. 2025**, nga ora **8:00 - 16:00**, pranë sekretarisë së Senatit Akademik.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për njohje e zbatim të gjitha njësive kryesore në USH.

REKTORI
Prof. dr. **Tomir Guraj**